



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 16/15

Prishtinë, më 29.4.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Ilir Deda, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Bojan Mitić.

Pjesëmarrës të ftuar: Dritan Gjonbalaj – Drejtor i Përgjithshëm nga AAC, Shqipe Selishta – Zyrtare Financiar e Buxhetit nga AAC, Ylber Aliu – Drejtor i Departamentit të ABN-së nga AAC, Adnan Merovci – Kryetar i KPM-së, Naile Krasniqi – Kryeshefe Ekzekutive nga KPM, Ganimete Nuçi nga KPM, Arben Bilalli nga KPM, Bedri Mecini – Zyrtar Kryesor Financiar nga AKK, Dafina Hasametaj – Zyrtare për Buxhet dhe Financa nga AKK, Hasan Preteni – Drejtor i AKK-së.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga Zyra e Presidencës, Floriana Shala nga OSBE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 04.15.2015**
- 3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014;**
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës Rregullatore për Ujësjiellës dhe Kanalizim për vitin 2014;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014;**
- 7. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e dy pozitave për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së;**
- 8. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozoj të pika pestë e rendit të ditës : Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2014, të shtyhet, për shkak të mungesës së drejtorit të kësaj zyre, të cilit i ka skaduar mandati.

Kryetari konstaton se komisioni unanimisht miratoi rendin e ditës, me ndryshime, heqjen e pikës së pestë nga rendit i ditës. Në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014

Kryetari – njoftoj se në bazë të nenit 15.2 të Ligjit për AAC-e nr. 03/L-051, Drejtori i Përgjithshëm duhet të përgatisë, përfundojë dhe sigurojë Bordit, Ministrisë, Qeverisë dhe Kuvendit, një raport gjithëpërfshirës vjetor deri me 31 mars, i cili siguron informata të hollësishme për vitin e shkuar kalendarik. Autoriteti i Aviacionit Civil ka përgatitur raportin e shpenzimeve për vitin 2014.

Dritan Gjonbalaj – raportoj në lidhje me performancën buxhetore dhe financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014. Buxheti i aprovuar për AAC- në vitin 2014 ka qenë 783,000 euro të ndarë sipas kategorive, për paga dhe mëditje 492,508 euro, për mallra dhe shërbime 274,330 euro, dhe për shpenzimet komunale 16,162 euro. Ndërkaq, në bazë të Vendimit të Qeverisë është bërë zvogëlimi i buxhetit prej 15% nga kategoritë për mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale. Buxheti final i AAC-së është 841,375 euro të ndarë sipas kategorive, për paga dhe mëditje 594,457 euro, për mallra dhe shërbime 235,856 euro, dhe për shpenzimet komunale 11,062 euro. Ndërsa gjithsej janë shpenzuar 822,116 euro apo 98% të buxhetit përfundimtar. Për paga dhe mëditje janë shpenzuar 594,457 euro apo 100%, për mallra dhe shërbime 220,039 euro apo 93%, dhe për shpenzime komunale janë shpenzuar 7,619 euro apo 69%. AAC realizon të hyra nga tarifat e licencimit të çertifikimit dhe tarifa të sigurisë, që merren nga çdo udhëtar që udhëton në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës dhe gjatë vitit 2014 ka mbledhur 1,368,546 euro që janë të ardhura të dedikuara në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit dhe Ligjin e Aviacionit Civil. Numri i personelit të AAC-së në fillim të vitit 2014 kanë qenë 27 punëtorë. AAC ka 26 punëtor me orar të plotë dhe një punëtor është me gjysmë orari. Me vendim të Qeverisë së Kosovës, të datës 19 Shkurt 2014 është emëruar Zv. Drejtori i përgjithshëm i AAC-së dhe si rrjedhojë i këtij vendimi, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave kanë shtuar këtë pozitë në listën e pagave. Ministria e Financave ka bërë alokimin e parakohshëm të mjeteve në lartësinë e pagave të miratuara për Zv. Drejtorin e përgjithshëm, në mënyrë që të përfshihet në ligjin e Kuvendit me rishikim të buxhetit. Pasi që nuk pa pasur rishikim të buxhetit pozita është përfshirë në ligj vetëm me ligjin e buxhetit për vitin 2015.

Kryetari – AAC ka një punëtor më tepër si rezultat i vendimit të Qeverisë, nga numri i të punësuarve me rastin e miratimit të buxhetit 2014.

Dritan Gjonbalaj – sqaroj se me vendim të Qeverisë, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave kanë shtuar një vend në listën e pagave, gjithashtu kanë alokuar mjetet e nevojshme për këtë pagë dhe të reflektohet në ligjin e buxhetit në rishikim. Në disa kategori dhe nën kategori kemi tejkalime të vogla dhe realizimi është mbi 100% si rezultat i planifikimit për shkurtime të mëdha. Një nga kategoritë që ka tejkalim është kategoria për udhëtime zyrtare, ku janë shpenzuar 65,951 euro apo 114% nga planifikimi prej 56,824 euro. Një pjesë e madhe prej 85% e shpenzimeve të udhëtimit janë të ndërlidhura me trajnimet profesionale të personelit. Ndërsa pjesa tjetër prej 15% është pjesëmarrje me qëllim të përfaqësimit të Autoriteteve të Aviacionit Civil në eventet të ndryshme ndërkombëtare. Specifika e punës së personelit teknik profesional dhe nxjerrja e vazhdueshme e legjislacioneve në

fushën e Aviacionit në BE të cilin ne jemi të detyruar ta implementojmë kërkojnë trajnim të vazhdueshëm të personelit. Këto trajnime janë të detyruara dhe monitorohen në vazhdimësi nga Agjencia Europian e sigurisë Aviacionit dhe nga Komisioni Europian dhe është detyrim i Kosovës në kuadër të marrëveshjes për hapësirën e përbashkët Evropiane të Aviacionit. AAC gjithashtu ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën e auditimit dhe inspektimit nga Autoriteti i Aviacionit të Shqipërisë dhe sipas kësaj marrëveshje pala që i ofëron ndihmë palës tjetër i bart shpenzimet e inspektorëve të vetë. Është edhe një tejkallim prej 50 euro në nën kategorinë për blerje të mobileve dhe paisjeve. Karburant për vetura kemi tejkalluar 3% të buxhetit nga ajo që ka qënë e planifikuar. Përkundër tejkallimit, kostoja mujore për karburant në vetura të ACC-së është 103 euro. Ka tejkallime për shërbime shtypje jo marketing kjo është për shkak 20 pilotëve të licencuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Gjithashtu për shërbime kontraktuese tjera ka një tejkallim prej 24% për arsye se është planifikuar një organizim i një konference ndërkombëtare, sipas kërkesës së Komisionit Europian. AAC ka pasur edhe kurse në krahasim me vitin e kaluar 2013.

Kryetari – njofton se raporti vjetor financiar i Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014 është përgatitur mirë teknikisht dhe ofron të dhëna të mjaftueshme për shpenzimin e buxhetit. Një pyetje, sa i përket të hyrave, që janë të dedikuara për AAC-në, sipas ligjit, por çfarë ndodhë në pjesën e pasqyruar të mjeteve, apo në rast se të hyrat janë më të larta se buxheti i AAC-së, pjesa që mbetet a derdhet në buxhetin e Kosovës?

Dritan Gjonbalaj – të hyrat e dedikuara të Autoritetit të Aviacionit Civil janë fonde publike që derdhen në thesarin e Republikës së Kosovës. Ne përgatisim kërkesat buxhetore në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Ilir Deda – jeni Institucion me të cilin ne krenohemi. Por kam dy pyetje. A keni staf të mjaftueshëm për funksionim optimal? Dhe a keni filluar trajnimet e njerëzve tanë për kontrollin e hapësirës që aktualisht kontrollohet nga Hungaria?

Enver Hoti – e përgëzon drejtorin për punën e agjencionit dhe për raportin, që po funksionojnë shumë më mirë edhe pse nuk ka bord.

Besa Gaxherri – në bazë të raportit për paga dhe mëditje janë shpenzuar 594,000 euro, për mallra dhe shërbime 220,000 euro dhe për shpenzime komunale 7,600 euro. Me 27 punëtor janë shpenzuar 594,000 euro për paga dhe mëditje, dhe mesatarja e pagave del e mirë. Një vërejtje për telefoni fikse dhe mobile së bashku janë 12,000 euro kjo është shumë duhet të përgjysmohet. Pastrimi për vitin e kaluar në shumë prej 6,400 euro dhe këtë vit prej 3,495 euro është shumë, dhe me qenë ka punëtor të mjaftueshëm dhe paguhen mirë duhet bërë pastrimi vet. Njëkohësisht, sa i përket të hyrave, shifet se ka rënie të hyrave në krahasim me vitin e kaluar, për arsye se ka 14% rënie të numrit të udhëtareve.

Dritan Gjonbalaj – Autoriteti i Aviacionit Civil ka staf të mjaftueshëm tani për ushtrimin e të gjitha përgjegjësiave me ligj. Republika e Kosovës ka kontrollor të trafikut ajror në numër të mjaftueshëm për të ofruar edhe shërbime në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës. Agjencia ka filluar trajnimin e kontrollorëve për të marrë edhe rejtting shtesë për licencën e mbi kalimeve dhe në afatin 4 vjeçar kur përfundon kontrata e NATO-së në Hungari do të jemi të gatshëm të ofrojmë shërbime në hapësirën ajrore. Është e vërtetë se pagat në AAC janë mjaftë të larta se sa mesatarja në shërbimin publik të Republikës së Kosovës dhe kjo na jep përgjegjësi shtesë mirëpo, për dallim prej rregullatorëve tjerë çështja e pagave tona është shumë e rregulluar me ligjin për Aviacionit Civil, përcaktimi i pagave është kompetencë ekskluzive e Ministrit të Financave. Jemi përpjek që të bëjmë shkurtim në shpenzimeve shtesë për pastrim dhe pastrimin e ka si detyrim pronari i shtëpisë. Objekti ka hapësirë të madhe më shumë se sa nevojitet për personel. Mirëpo kostoja e qirasë është shumë efektive.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014.

2. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014

Adnan Merovci – buxheti i aprovuar i KPM-së është 1,483,539 euro dhe për shkak shkurtimeve me vendim të qeverisë prej 15% në mallra dhe shërbime prej 42,000 euro dhe shpenzime komunale prej 4,500 euro, KPM është dëmtuar shumë. Në mallra dhe shërbime kemi qenë të dëmtuar sepse ka qenë një proces decentralizimi i cili ka ndikuar në implikime financiare të cilat edhe në rishikim të vitit kaluar nuk ka pas sukses. Duke pasur parasysh çështjen e rritjes së mediave, që janë 200 entitete mediale të cilat përpos të punës së rregullimit që bëhen ato kontrollohen, monitorohen, licencohen dhe në përmbajtje krahasohen me ligjshmërinë dhe zbatueshmërinë e ligjit, me vetëm me 30 punëtorë është pak problem me krye këtë punë. Jemi shëndrruar në institucion si lypsa tek donatorët të ndryshëm për të financuar konsulentë dhe ekspertë që duhet të angazhohjmë. Nëse në rishikim nuk ka ndonjë ndërhyrje, për shkak edhe të obligimeve që kemi bartur nga viti i kaluar, do të rezultojë në minus apo mungesë të mjeteve në fund të këtij viti.

Kryetari – në bazë të të dhënave në raport, shifet se nuk ka tejkalime dhe raporti është në rregull. Kërkesat janë çështje e takimit tjetër ose në rishqyrtim të buxhetit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media vitin 2014.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2014

Hasan Preteni – theksoj se Agjencia ka buxhet të mjaftueshëm që nga viti 2006. Nuk kemi planifikuar punësim shtesë dhe nuk kemi shpenzime kapitale, tani qëndrojmë në objekt shtetëror. I vetmi element që është diskutuar edhe në komisionet tjera është niveli i pagave, që ka ndikuar shumë në motivimin e zyrtarëve që të qëndrojnë në agjenci dhe mos të largohen nga agjencia. Drejtori i Agjencisë ka një pagë të dinjitetshëm, por problemi është tek zyrtarët dhe që nga viti 2006 janë larguar më shumë se 20 zyrtar nga Agjencia për shkak të pagës. Rritja e pagës do të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe në motivimin e zyrtarëve në Agjencion.

Kryetari – theksoi se agjencioni ka tejkalime në disa nënkategori, si për blerje të mobileve dhe paisjeve dhe duhet arsyetim për nënshpenzimet për marketing.

Besa Gaxherri – theksoj se për çështjen e pagave është ligji dhe pagat përcaktohet në bazë të ligjit. E kam një vërejtje për shpenzimet e telefonit dhe kërkojë sqarim. Përndryshe e përgëzoj Agjencinë për punën e bërë.

Ilir Deda – vitin e kaluar është paraqitur një rast në zyrën tuaj, në lidhje me një dyshim të bazuar për keqpërdorimin 8,000,000 euro në KOST, pyetja ime është a jeni marr me këtë rast të dyshuar?

Dafina Hasanmetaj – sa i përket telefonisë fikse nuk kemi pas asnjë tejkalim. Shpenzimet e marketingut janë ulur, këto kanë qenë të planifikuara tek publikimet. Sa i përket mobileve është një pjesë që është shpenzuar jashtë asaj që ka qenë e nevojshme, por kemi pasur nevojë dhe ashtu ka ndodhur tejkalimi, por nuk është shumë e madhe që kemi tejkaluar.

Kryetari – theksoi se, pavarësisht nga shumat e tejkalimeve, ato duhet arsyetuar.

Enver Hoti - atë që e deklaroj zoti Preteni për mua është pak shqetësuese, dhe nëse nuk ka gatishmëri për ekspertet të fushave të caktuara për tu bërë pjesë e kësaj agjencie, për mua kjo është vërtet shqetësuese. Ka shumë institucione që merren me luftimin dhe parandalimin e dukurive negative, e konkretisht korrupsionit, më intereson me ditë cilat janë sfidat në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve me këto institucione, a ka ndonjë përparim në vitin 2015 dhe a pritet avancim në këtë nivel të bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve, në të ardhmen?

Hasan Preteni - dua të siguroj se asnjë rast që nga viti 2006 nuk ka ndodhur që të ndërrohen mobilet e një pse iu ka kaluar koha, por vetëm nëse janë prishur. Por në vitin 2010 kur kemi kaluar nga shtëpitë private në objekt shtetëror është dashur me të bëjmë pak ndërhyrje. Sa i përket shpenzimeve për telefon, përveç drejtorit, secili zyrtar i ka të lejuar edhe nga 20 euro mbushje, kurse për shpenzimet e telefonisë fikse, përveç muajit mars, kur është koha e deklarimit të pasurisë, asnjë zyrtarë nuk shpenzon telefoni fikse më shumë se 10 euro. Sa i përket pyetjes për hetimin, institucioni që u përmend ka qenë pjesë e hetimit të agjencisë, por bazuar në legjislacionin në fuqi nuk mund të flasim për emra, por të gjitha emrat për të cilët janë bërë kallëzimet penale, janë të njohura për prokurorinë. Sa i përket pyetjes për bashkërendimin e aktiviteteve ka qenë një ide e mirë dhe ne kemi vlerësuar për nevojën e një mekanizëm koordinues në mes institucioneve relevante në këtë fushë, tentoji të bëhet por degradojë.

Bardhyl Meta - është brengosë çështja e pagave dhe ikja e personelit apo pamundësia e rekrutimit të stafit të kualifikuar në agjenci. Sa i përket çështjes së investimeve të huaja, kur kam qenë drejtor i Odës Gjermane, jam njohur me problemet se një ndër shkaqet që ikin investitorët është edhe burokracia në departamente të ministrive të ndryshme apo agjencioneve. Në çdo institucion e ke një shtresë të burokracisë së mesme e cila është pengesa kryesore dhe korrupsioni është në lulëzim. Pse i përmenda krejt këto, sepse te ne kemi buxhet që po na ik prej dorës, por ndahet për qëllime tjera dhe nuk po shkon aty ka nevojë dhe duhet, siç është rasti këtu për fuqizimin e institucionit për antikorrupsion. Prandaj, ju duhet të bëni një kërkesë zyrtare te Kryeministri e ministri i financave, kur dihet se edhe një muaj e kemi rishikimin e buxhetit dhe kjo politikisht mbështetet, dhe do ta keni edhe përkrahjen tonë, që agjensioni me i ngritë kapacitetet profesionale. Unë të huajve ju kam thënë se po investohet për antikorrupsion aty ku nuk duhet, kurse tek ju ka nevojë me pas departamente të veçanta, me pas gazetari investigativ, që bëjnë raporte që të mundeni me qenë më konkret në punë dhe veprim.

Kryetari – është akuzuar një deputet për mos paraqitje të saktë të pasurisë dhe e keni humbur lëndën. Pyetja ime është pse e keni paraqitur kallëzim ndaj një zyrtari të lartë të institucionit të Kosovës, pa pas fakte të sigurta për mosdeklarimin e pasurisë?

Hasan Preteni - nuk është problem i agjencionit, por i Kuvendit i cili e ka miratuar një ligj të tillë po Kodin e ri penal dhe sipas ligjit, nga 1 janari 2013 mosdeklarimi i pasurisë është vepër penale. Deklarimi i pasurisë duhet të bëhet deri më 31 mars, dhe cila është e drejta e agjencisë që të pranojë dokumentin e deklarimit të pasurisë nga personi përgjegjës më 5 prill, kur afti është më 31 mars. Zyrtarët e larët, duke filluar nga Presidentja e deri të një zyrtar më i ulët, janë zyrtar përgjegjës për deklarimin e pasurisë dhe ne i trajtojmë njësojë sepse para ligjit të gjithë janë të barabartë. Ushtrimi kallëzimit penal bëhet për mosdeklarimin e pasurisë me vlerë prej mbi 5,000 euro. Për rastin e deputetes

në fjalë, në mes të hyrave të deklaruara dhe të hyrave që i kemi siguruar në Ministrinë e Financave, diferenca është më shumë se 6,000 euro, kështu që në bazë të ligjit ne jemi të detyruar të ushtrojmë kallëzim penal.

Kryetari - në deklarimin pasurisë, gjithmonë ngritet një kallëzim për shkak, se ne nuk e bëjmë deklarimin e saktë të pasurisë. Psh. për vlerën e banesës sime, unë deklaroj një shumë të caktuar të vlerës së saj, agjencia munden me thënë se vlera është më e madhe, dhe si rezultat bëjnë kallëzimin penal, për mosdeklarim të saktë të shumës.

Besa Gaxherri – ne jemi të gjithë njësojë para ligji, por mendojë se nuk është asgjë e keqe, nëse një deputet e kontaktoni dhe konsultoheni për të dhënat e deklaruara në formular, sepse ka paqartësi edhe në formularët e deklarimit të pasurisë. Unë e kam shikuar këtë vit formularin dhe i kishit mbledhur tri vitet e fundit të dhënat për gjendjen e pasurisë, dhe që për mua është krejtësisht gabim i juaj, por që qon peshë në publik. Prandaj, është e domosdoshme që të konsultoheni paraprakisht me zyrtarin përkatës, dhe në rast se nuk ofrohen sqarimet dhe faktet për shënimet e paraqitura në formular, atëherë mund të ndërmerrni veprimet tjera ligjore.

Hasan Preteni - sqaroj se vlera e pasurisë nuk kontrollohet nga agjencia. Të dhënat për të hyrat i sigurojmë nga institucionet përgjegjëse, si nga ministria e financave, në rast se është fjala për të hyrat që merr një zyrtar nga buxheti i Kosovës apo nëse është fjala për mos regjistrimin e një biznesi, të dhënat i kërkojmë në agjencia për regjistrimin e bizneseve. Sa i përket formularëve, mundet me qenë një problem sepse janë katër lloje të formularëve për deklarimin e pasurisë. Por formulari i ka edhe pjesët e hijezuara për të dhënat personale dhe kur të publikohen formularë, hiqen ato pjesët e hijezuara. Por edhe gabimet janë të mundshme.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë Raportin vjetor financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit vitin 2014.

6. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Seleksionues të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për plotësimin e dy pozitave për anëtar joekzekutiv të Bordit të BQK-së

Kryetari - theksoi se e kemi stërgjatë këtë lëndë, kjo edhe për faktin se emrat janë propozuar në mandatin e kaluar, dhe mosfunksionimi i institucioneve dhe krijimi i raporteve tjera në institucionet e krijuar ë gjithë këto kanë ndikuar. A kam të vështirë të jap ndonjë propozim, kur dihet se tash bëhen një vit kur janë përzgjedhur kandidatët.

Safete Hadergjonaj - neve si deputet e shqyrtojmë listën e kandidatëve, e cila na vjen nga Banka Qendrore e Kosovës. Ata e bëjnë një përzgjedhje në bazë të panelit seleksionues që krijohet, dhe ne shikojmë arsyeshmërinë ligjore, a i plotësojnë kandidatët kushtet formalo-juridike dhe a ka shkelje ligjore të procedurave deri ne ardhjen e propozimeve në Kuvend. Nëse ne nuk vërejmë se ka shkelje ligjore apo procedurale dhe kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore, ne si Komision i procedojmë kandidatët për votim në seancë plenare dhe aty vendos për përzgjedhjen apo jo të tyre. Prandaj, propozojë që ti dërgojmë propozimet për votim në seancë.

Ilir Dedaj - po e shof se kanë kaluar më shumë se një vit kur janë dërguar propozimet dhe unë mendojë se duhet përsëritur konkursi dhe të zhvillohen të gjitha procedurat dhe të dërgohet propozimi i ri.

Latif Gashi – në bazë të këtyre dokumenteve, nuk flitet për një vit por për një procedurë shumë të rregullt dhe materiali ka ardhur në fund të dhjetorit 2014, pra që tre muaj. Unë jam me i procedue propozimet për seancë plenare.

Kryetari – sqaroj se selektimi është bërë me 16 prill 2014, ndërsa në dhjetor kanë ardhur për herë të dytë, pasi që janë konstituar institucionet.

Latif Gashi - nuk bënë me e prish një traditë që e ka pas ky komision, ne asnjë herë nuk ju kemi përzier në punë të këtij paneli. Unë besojë që këto propozime kanë ardhur pasi që ka filluar funksionimin Kuvendi. Bordi i BQK-së nuk është sa duhet funksional, për shkak të mungesës së dy anëtarëve, kërkojmë që të rekomandojmë për seancë.

Kryetari – në bazë të diskutimeve i kemi dy propozime: Propozimi i parë është për ti rekomanduar seancës plenare votimin e dy kandidatëve të propozuar nga Paneli Seleksionues. Propozimi i dytë me i rekomandue seancës, që të mos votohen kandidatët e propozuar dhe Kuvendi të kërkojë përsëritjen e konkursit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me gjashtë vota Për, asnjë Abstenim dhe katër Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. I rekomandon Kuvendit, të përzgjedhë dy kandidatë për pozitën e anëtarëve joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me votim të fshehtë, si në vijim: Mejdi Bektashi, Mimoza Mustafa, Behxhet Brajshori, Shyqiri Bytyqi, Zilif Lufi, Nuhi Ahmeti, Agim Vishi, dhe Xhemajl Gashi.
2. Kandidatët e përzgjedhur nga Kuvendi, t'i dërgohen Presidentes për miratim dhe emërim në pozitën e anëtarëve joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në ora 12:25

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani